



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 19.12.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj.

Munguan : Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB dhe MEF (ministri Stavileci dhe ministri Hamza), bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media. Prezantuan edhe dy praktikantë nga kolegji "Humanistika" në Ferizaj, Rifat Haziri dhe Egzon Sadiku, ndërkaq ishin ftuar nga kryetari i komisionit përfaqësuesit e shoqatës për verëra Ismet Haxhimurati, Enver Sylka, Halim Haxhijaha dhe Shani Mulla Abazi.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.12.2011,
3. Takimi me ministrin e bujqësisë dhe ministrin për financa.
4. Konfirmimi për leximin e dytë të Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe Projektligjit për rregullimin e tokës, pas rekomandimeve të arritura nga Komisionet e përhershme.
5. Të ndryshme .

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.12.2011**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.12.2011.

### **3. Takimi me ministrin e bujqësisë dhe ministrin për financa rreth akcizës për verëra dhe konfirmimet për leximin e dytë për disa projektligje**

**Kryetari Nait Hasani** falënderoi dy ministrat për pjesëmarrje, por pasi që ministri për financa u vonua pak, filloi me shqyrtimin e pikës së radhës. Ai sqaroi se **Projektligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria nukleare** me amendamentet e këtij komisioni janë shqyrtuar nga komisionet e përhershme, mirëpo për shkak të vërejtjeve të komisionit për buxhet rreth implikimeve financiare (Agjencia si organ i pavarur, buxhetin dhe drejtorin e së cilës duhet ta caktoj Kuvendi, krijon obligime buxhetore shtesë), është dashur të hartohen amendamentet shtesë, përndryshe ai konstatoi se ky komision është sugjeruar nga Ambasada Amerikane për miratim të këtij projektligji si agjenci e pavarur. Në vazhdim komisioni u njoftua për amendamentet shtesë :

#### **Amendament 1**

**Neni 4**, paragrafi 1, në rreshtin e parë fjala “Kuvendi” zëvendësohet me “**Qeveria**”.

#### **Amendamenti 2**

**Neni 7**, fjala “Drejtori” zëvendësohet me “**Kryeshefi**”.

Ky zëvendësim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

#### **Amendamenti 3**

**Neni 8**, riformulohet :

#### **Neni 8**

#### **Procedurat e zgjedhjes së Kryeshefit**

1. Kryeshefi zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e dy kandidatëve nga Qeveria me një mandat pesë (5) vjeçare, me mundësi të emërimit edhe për një mandat.

2. Qeveria, dy (2) muaj para skadimit të mandatit të Kryeshefit të Agjencisë, i propozon Kuvendit të Kosovës dy (2) kandidatët për Kryeshef të ri.

3. Kandidati për Kryeshef duhet të plotësoj kushtet e mëposhtme:

3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Kosovës;

3.2. të ketë së paku diplomë universiteti ose master i fushës përkatëse;

3.3. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale;

3.4. të ketë integritet të lartë moral;

3.5. të ketë përvojën e duhur profesionale.

#### **Amendamenti 4**

**Neni 9**, paragrafi 1.6 riformulohet :

-me shkarkim nga Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, për shkak të dështimit në përmbushjen e mandatit ligjor.

#### **Amendamenti 5**

**Neni 12**, riformulohet :

Agjencia përmes Qeverisë, paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më së voni deri më datën 31 mars.

#### **Amendamenti 6**

Fshihet Kreu III me Nenet 13 dhe 14.

Kreu IV bëhet Kreu III.

#### **Amendamenti 7**

**Neni 16**, paragrafi 4 riformulohet :

Në raportin vjetor të Agjencisë raportohet edhe për ecurinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

#### **Amendamenti 8**

Pas **Nenit 22**, shtohet :

#### **Neni 23**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen neni 6 dhe neni 7 të Ligjit nr. 03/L-104 për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare.

Duke pasur parasysh se qëndrimet janë kundërthënëse, **kryetari i Komisionit** arsyetoi amendamentet e lartcekura. **Liburn Aliu** numëroi disa shtete që kanë këtë agjenci pranë ministrisë përkatëse, çka do të ishte e arsyeshme edhe për ne, ngase shteti ynë i cili nuk ka ndonjë teknologji të fortë ose fuqi bërthamore, nuk do të mund të përballoj shpenzimet e larta, sidomos kur është fjala për këtë agjenci e cila do të lëshoi ca licenca për rreze X (rëntgeni). Kur të zhvillohet kjo agjenci në kuadër të ministrisë, atëherë pavarësohet, përfundoi.

**Salih Morina** pyeti kush i ka hartuar amendamentet, kryetari u përgjigj se ato janë hartuar bashkërisht me konsulentin ligjor Elton Tota, stafi i komisionit dhe sipas sugjerimeve të komisionit për buxhet. Ai sugjeroi se do të ishte mirë të pyetet ministria (MEF) apo Qeveria për ndikime buxhetore, “përndryshe do të mbetemi të përçarë”, tha. **Kryetari i komisionit** përsëri sqaroi se komisioni për buxhet ka miratuar një rritje për këtë agjenci duke numëruar disa shtete që kanë këtë agjenci të pavarur, mirëpo **Liburn Aliu** konstatoi se rritja prej 20.000 në 30.000 euro për paga nuk zgjedh problemin. **Afërdita Berisha** dhe **Salih Morina** në vazhdim ishin me dilema ngase sipas deklaratës ekzistuese financiare është i papranueshëm ky ligj, ndërsa **Liburn Aliu** tha se nuk ka mundësi me këtë buxhet të shkoj ky ligj sepse te ne ndonjëherë po dominon mendimi “unë bëhem i pavarur edhe pa parë”.

**Nait Hasani** sugjeroi që komisioni të konsultohet në ditët në vijim me amendamentet e propozuara dhe pas dy ditësh të takohet në njërën nga pauzat e mbledhjes plenare, nëse ka mundësi për këtë, ndërkaq **Salih Morina** dhe **Liburn Aliu** kërkuan mendimin e ministrit **Bedri Hamza** i cili posa prezantoi. Ai tha se ky ligj duhet të harmonizohet me mundësitë tona financiare përkundër arsytetimeve që epen se duhet të jetë agjenci e pavarur. MMPH duhet të akomodoj këtë agjenci në brendinë e saj. Mendimi se një agjenci mbulohet me të hyrat që do ti krijoj, është i gabueshëm por edhe nuk është e lejueshme, ngase aktivitetet duhet të mbulohen nga buxheti, përfundoi. **Nait Hasani** ishte i mendimit që projektligji duhet të shqyrtohet ashtu si është propozuar, ndaj përfundoi këtë pikë sipas konstatimit të cekur më lartë që të shqyrtohet prapë në ditët në vijim, të mërkurën.

**Nait Hasani** në vazhdim kaloi në shqyrtimin e pikës paraprake të kërkesës të shoqatës për verëra nga Rahoveci për të hequr akcizën për verëra, për të cilin kërkesë në këtë komision është debatuar një herë dhe është thënë se do të kontribuohet me subvencione, jo përmes heqjes së akcizës.

**Ministri Bedri Hamza** përsëriti konstatimet e mëhershme të dhëna në këtë komision ngase interesi shtetëror është zhvillimi i ndërmarrjes prodhuese, por në treg duhet të depërtohet me kualitete të caktuara. Në këtë moment Kosova përafërsisht merr 500.000 euro në vit akcizë nga verërat, e cila akcizë i kthehet fermerëve përmes subvencioneve (rimbursimi i akcizës). Në këtë drejtim MEF bashkërisht me MB do të shqyrtojnë rritjen e fondit për subvencione në ministrinë e bujqësisë për një vit. Ai konstatoi se politika fiskale e Kosovës është më e ulëta në Evropë.

**Ministri Blerand Stavileci** u pajtua me sugjerimet e ministrit Hamza dhe arsyetoi politikat zhvillimore në ministrinë e bujqësisë, garantoj se kjo degë xhelozohet nga degët tjera, ngase në këtë ministri është më e avancuara. Ai, sikurse ministri Hamza premtoi se do të bëhet përpjekje e përbashkët për atë që u sugjerua për një subvencionim më të lartë sesa është tani. Ai shtoi se kjo ministri nuk subvencionon por garanton vreshtat (mbi 512 ha).

**Përfaqësuesit prezent** të shoqatës së verërave falënderuan për bashkëbisedën dhe konstatuan se ata vet e kanë kërkuar akcizën, mirëpo në vazhdim është pa se bëhen falsifikimet e ndryshme, ndaj kjo degë nuk mund të zhvillohet pa përkrahjen e shtetit. Prodhuesit e kësaj ane janë inkuadruar në tregun global me 150.000 milion euro në këtë biznes, por nëse nuk sigurohen kushte të barabarta, ata shndërrohen në humbës të mëdhenj, ngase në “ring” duhet të hyjmë të barabartë (në Shqipëri pyesin pse me ble prej juve venën 1,5 euro kur prej Italisë blejmë 1 euro). Ata konstatuan se duhet të punohet për këtë veprimtari ngase do të ndodhin shumë punësime etj. Në Maqedoni, vazhduan sqarimet, për një vit fermeri merr 2500 euro për një ha, 650 euro për mirëmbajtje të vreshtës, 3 cent për çdo litër si dhe akcizë nuk ka apo nuk ekzekutohet. Nga asnjë vend ku është eksportuar vena e Rahovecit, nuk ka pasur vërejtje për kualitet. Ata shprehën kënaqësinë sa i përket regresimit me derivate të naftës, ngase çdo vreshtar mund ta gjej këtë nëse kërkon. Pasi që 516.000 familje jetojnë nga ky biznes, z. Sylka tha se nuk do të dëmtohet shteti

me heqjen e akcizës përkundrazi do të dëmtohen keqpërdoruesit ose keqpërdoruesit e akcizës, me çka do të ketë ngritje të pagesës së TVSH. Ata potencuan edhe problemin e TVSH së sheshtë e cila duhet të aplikohet edhe te ne, Kosova nuk ka kuota me Shqipërinë e ashtuquajtura “barriera e kuotave”, importuesi jonë paguan një taksë me çka largohet automatikisht nga tregu. Përveç kësaj, imazhi i Kosovës do të krijohet ngase shumica e shteteve të rajonit mendojnë se Kosova si shtet mysliman nuk prodhon verëra.

**Ministri Hamza** për të qenë më i qartë ishte i gatshëm për zbatimin e ndonjëres nga sugjerimet e dëgjua, por konstatoi se më i miri do të ishte të hiqet dogana e ambalazhës me çka do të rritej rimbursimi i akcizës, ashtu si u konstatua më lartë. **Afërdita Berisha** pyeti çka nëse bënë shteti ynë “barrierën e kuotave” ndaj Malit të zi, për çka ministri tha se nuk është zgjidhje e duhur ngase nuk preferohet nga BE.

Në fund, përfaqësuesit e shoqatës së verërave, të relaksuar me bisedën që kishin, kërkuar sqarime nga ministri Hamza kur mund të pritët premtimi i dhënë nga ky takim, dmth rritja e subvencioneve kur mund të pritët. Ai tha se menjëherë me rishikimin e parë të buxhetit, në korrik 2012.

**Liburn Aliu** përkrahu mosheqjen e akcizës me idenë e subvencionimit nga Ministria të kësaj akcize, bazuar nga fakti se buxheti merr 1.5 milion euro në vit nga akciza e verërave të importuara dhe vetëm 0.5 milion nga ato vendore, dhe heqja e akcizës do të duhej të bëhej pastaj edhe për verërat e importuara, një gjë e tillë nuk do të favorizonte verërat e brendshme. Kështu me akcizë dhe subvencionim të saj për verërat e Kosovës kemi llogari edhe ta rrisim akcizën, p.sh. po të rritej 100% nga verërat e importuara do të merrnim 3 milion dhe nga ato vendoret 1 milion të cilat pastaj do të subvencionoheshin nga akciza e verërave të importuara. Kjo do të favorizonte produktin vendor, do të stimulonte prodhuesit ta legalizojnë prodhimin dhe buxheti nuk do të prekej.

**Daut Haradinaj** pyeti ministrin a i subvencionon ministria e bujqësisë vreshtat jashta akcizës. Ministri përsëriti atë çka tha më lartë se kjo degë është më e avancuara në ministri duke cekur se mbi 512 ha grantohen vreshtat, çka do të vazhdoi edhe në vitin vijues si një sektor i avancuar.

**Nijazi Idrizi** konstatoi se kërkesa për heqjen e akcizës është pak sa jo e rëndomtë dhe nuk është me kohë, ngase do të kishim pasoja jo të mira. Duhet të shfrytëzohet dhe të punohet sa më shumë me Entin për verëra i cili duhet të jetë në shërbim të fermerëve verëtar për të vazhduar zingjiri i prodhimit deri te dalja në shitje. Përndryshe ai konstatoi se pa subvencione dhe grante, vështirësi do të kemi.

**Sevdije Lama** u angazhua për marketingun e procesit të prodhimit në mënyrë që të shihet zingjiri i prodhimit që bëhet këtu në Kosovë. Reagoi përfaqësuesi i shoqatës dhe tha se ky kosto financiar do të gjunjëzonte edhe më tepër këtë degë në Rahovec, ngase reklama duhet të paguhet. Në fund të takimit, të gjithë pjesëmarrësit ishin të pajtimit për konstatimin si vijon :

## K O N K L U D I M

**Akciza për verëra të mbetet por të shtohen subvencionet nga Ministria e bujqësisë për fermerët, me bashkëpunim të ministrisë për financa, duke filluar që nga mundësia e parë për rishikimin e buxhetit për vitin 2012.**

## 5. Të ndryshme

**Kryetari i Komisionit Nait Hasani** në këtë pikë vazhdoi me pikat tjera, si vijon :

Pas përfundimit të shqyrtimit të Projektligjit për Rregullimin e tokës nga komisionet e përhershme, komisioni nxori :

## P Ë R F U N D I M

**Dërgohet në leximin e dytë Projektligji për rregullimin e tokës me amendamentet e komisionit funksional, të shqyrtuara dhe të miratuara nga komisionet e përherëshme të Kuvendit.**

**Sevdije Lama** pyeti pse ky Projektligj nuk ka ofruar zgjedhje për situatat kur autostrada ka shkëputë në dy pjesë parcelën e një pronari, ngase tani ai pronar ka shumë vështirësi të punoi. **Kryetari i Komisionit** u përgjigj se kjo çështje do të rregullohet me Ligjin për Tokën bujqësore, i cili ligj është monitoruar nga ky komision dhe janë sugjeruar zgjidhjet optimale për pronarët e tokave bujqësore.

**Për leximin e parë të projektligjit për Qendrën historike të Prizrenit , kryetari i Komisionit Nait Hasani** tha se janë dërguar amendamente shtesë nga Qeveria ku “është përmirësuar” neni 18.4 dhe janë bërë disa përmirësime tjera teknike. Kryetari Nait Hasani ka shkuar në Prizren ku ka biseduar me zyrtarët e atjeshëm të cilët kanë theksuar se me këto amendamente MMPH mundohet të vejë në lajthitje deputetët e Kuvendit të Kosovës për ta votuar këtë Projektligj. Edhe **Liburn Aliu** i cili tha se ka pasur një takim ku kanë marr pjesë edhe përfaqësuesi i ICO, tha se askush nuk kishte përgjegje për nenin 20.3 (lidhur me rolin e KZM) i cili nen këtë komision e bënë autoritetin qendror, derisa pakoja e Ahtisarit këtë nuk e thotë, dmth ky autoritet nuk mund të udhëheq me tërë zonën por vetëm ku ka serb. Me këtë synohet që tërë qendra të trajtohet si kulturë serbe. Ai sugjeroi anëtarëve të komisionit, nëse votohet ky projektligj, do të thotë se është votuar për një gjë të tillë që ai e sqaroi, ngase në takimin ku ishte edhe ICO mbretëroi nervozizmi i tyre të cilët nuk kishin një shpjegim ndryshe.

Problemi tjetër edhe më i vështirë është, vazhdoi ai, nëse hiqet me amendament pika 20.3, kjo do të jet sikurse me prodhuan venën pa lëndë të parë (rrushin).

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,40.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryetari i Komisionit,

**Nait Hasani**